ОПШТИНА ЈЕГУНОВЦЕ - KOMUNA E JEGUNOVCIT
Бр.- Nr. 08 -269/1
06.02.20 25 год.-vit
ЈЕГУНОВЦЕ - JEGUNOVC

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

KOMUNA E JEGUNOVCIT

F. Jegunovc, Jegunovc

Në bazë të nenit 17-a dhe 26 të Ligjit për ndërmarrjet publike (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 38/96, 9/97, 6/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83 /09, 97/10, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15, 39/16, 64/18, 35/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës të Maqedonisë së Veriut", nr. 275/19, 89/22, 274/22 dhe 208/24), neni 36 paragrafi 5 i Ligjit për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 5/02).), neni 2 i Vendimit për themelimin e Komisionit Përzgjedhës për zgjedhjen e anëtarit në Bordi Drejtues të NPP„RUSINO POLLOG'' nr. 08-160/7, të datës 30.01.2025, Këshilli i Komunës së Jegunovcit, shpall:

THIRRJE PUBLIKE Nr 01/2025

Për paraqitjen e interesit për aplikim për kandidat për zgjedhje të anëtarit të bordit drejtues të NPP„RUSINO POLLOG''

1.Komuna e Jegunovcit me propozim të drejtorit të NPP "RUSINO POLLOG", në ueb faqen e Komunës së Jegunovcit www.opstinajegunovce.gov.mk, shpall thirrje publike për paraqitje të interesit për aplikimin e kandidatëve për zgjedhjen e 1 (një) anëtarit të bordit drejtues të NPP „RUSINO POLOG'', me seli në Sushicë, Gostivar.

2.Për anëtar të bordit drejtues të ndërmarrjes publike mund të jetë një personi i cili i plotëson kushtet e mëposhtme:
-të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
-të ketë të paktën 240 kredi të fituara sipas ECTS ose të ketë të përfunduar nivelin VII /1 të arsimit të lartë;
- në momentin e emërimit nuk duhet të jetë shqiptuar aktgjykim të formës së prerë me gjobë ose sanksion kundërvajtës që i ndalon ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- të ketë të paktën pesë vjet përvojë pune.

3.Me fletë aplikimin, kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formulari i aplikimit;
- Biografi e shkurtër;
- Certifikata e shtetësisë;
- Certifikatë ose diplomë e arsimit të lartë të përfunduar dhe të fituara të paktën 240 kredite sipas ECTS ose të përfunduar nivelin VII /1 të arsimit të lartë, të përshtatshme për pozicionin për të cilin aplikohet.

- Vërtetim se në momentin e emërimit nuk është dënuar me aktgjykim të formës së prerë me gjobë ose sanksion kundërvajtës për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Dëshmi për të paktën pesë vjet përvojë pune përkatëse për vendin për të cilin po aplikohet (Pasqyrë e të dhënave të regjistruara në regjistrin amë nga Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut);
- Certifikatat, licencat, diplomat e lëshuara nga institucionet e autorizuara, përkatësisht të akredituara për lëshimin e tyre në përputhje me ligjin për pozicionin e kërkuar;

4.Dokumentet nga pika 3 duhet të dorëzohen në origjinal ose kopje të vërtetuar te noteri dhe të njëjtat dorëzohen në arkivin e Komunës së Jegunovcit, me shënim: "Për thirrje publike për paraqitjen e interesit për aplikimin e kandidatëve për zgjedhjen e anëtarit të këshillit drejtues me shënim për pozitën për të cilën aplikohet dhe ndërmarrjen publike për të cilën po bëhet aplikimi''.

5.Anëtarin e Bordit të drejtues të ndërmarrjes publike e emëron gjegjësisht e shkarkon themeluesi i ndërmarrjes publike – Këshillin e Komunës së Jegunovcit.

6.Anëtari i Bordit Drejtues të ndërmarrjes publike nuk mund të jetë personi i cili ka interes personal, përmes një pale të tretë ose mbi çfarëdo baze, interesat në një ndërmarrje ose shoqëri tregtare që është në marrëdhënie biznesi me ndërmarrjen publike, të cilat mund të kenë ndonjë ndikim në pavarësinë dhe paanshmërinë e saj në vendimmarrjen e ndërmarrjes publike. Çdo anëtar i Bordit Drejtues është i detyruar të paralajmërojë themeluesin për ekzistimin e një interesi të tillë në një ose më shumë anëtarë të Bordit të Drejtues.

7.Mos përputhshmërisë me pozitën e kryetarit dhe anëtarit të bordit të drejtues të Ndërmarrjes publike me funksionin e Presidentit dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

8.Afati i fundit për regjistrimin e kandidatëve të interesuar është 5 ditë, duke filluar nga dita e publikimit të thirrjes publike.

9. Thirrja do të publikohet në ueb-faqen e Komunës së Jegunovcit.

10.Afati i fundit për regjistrim është 12 shkurt 2025.

11.Kandidatët që aplikojnë për anëtarë në më shumë borde drejtuese, duhet të paraqesin aplikim të plotësuar të veçantë për çdo pozicion për të cilin aplikojnë.

12.Formulari i aplikimit i pakompletuar, dokumentacioni jo i plotë dhe dokumentacioni i dorëzuar pas afatit të aplikimit nuk do të merret parasysh.

Këshilli i Komunës së Jegunovcit
Kryetar
Perica Saveski

РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА * РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА * КОМУНА ЈЕГУНОВЦЕ * ОПШТИНА ЈЕГУНОВЦЕ * РЕПУБЛИКА Е МАQЕДОНИСЕ СЕ ВЕРИУТ * КОМУНА Е ЈЕГУНОВЦИТ * ЈЕГУНОВЦЕ JEGUNOVC